TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL

TIRANA FILM INSTITUTE

Të rejat e edicionit të 23^{të}
Tirana International Film Festival 2025

Edicioni i 23^{të} i Tirana International Film Festival - *Oscar® & European Film Awards* qualifying do të mbahet nga data 21-27 shtator 2025.

Filmi më i mirë i shkurtër do të kualifikohet për 98th **Oscars® 2026** si dhe **European Film Awards 2025**.
Filmat studentorë të përzgjedhur zyrtarisht në TIFF kanë të drejtë të konkurrojnë për Çmimet ***Student Academy®*** (SAA).
TIFF është gjithashtu që prej vitit 2013 pjesë e 110 festivaleve më të rëndësishme në botë, që ndiqen me vëmendje të posaçme online, por edhe fizikisht nga **HFPA** – *Hollywood Foreign Press Associations.*

Programi Ditor i TIFF kombinon mbi 200 premiera të filmave në konkurim në të gjitha kategoritë dhe zhanret. Kalendari i këtij viti është pasuruar me një program special ekskluziv.

Ceremonia Galà e Hapjes do të organizohet të dielën, 21 shtator, ora 18:00, në kinema Millenium.
Pas Ceremonisë ky edicion i 23-të i TIFF 2025 do të hapet zyrtarisht me filmin ***Father Mother Sister Brother*** by **Jim Jarmusch,** i cili sapo pati premierën botërore në Festivalin e 82-të Venice International Film Festival 2025, ku u vlerësua me Luanin e Artë.

FOCUS

TIFF FOKUS këtë vit vë në qendër kinemanë e regjisorit islandez, Rúnar Rúnarsson, i cili me filmat e tij ka shenjuar ngadalë gjuhën e kinemasë nordike. Në filmat e tij, ai portretizon personazhe të kapur në rrjetën e hidhërimit dhe dramave të heshtura të përditshmërisë, duke ndërtuar poetikën e tij kinematografike mbi minimalizëm dhe ritme të qeta kohore.

Duke filluar me filmin e tij kyç të shkurtër ***The Last Farm***, që në mënyrë të butë trajton kalimin mes jetës dhe vdekjes, ai vazhdon me ***Volcano*** dhe Sparrows, secili prej tyre një analizë delikate e lidhjeve familjare dhe brishtësisë që ato përmbajnë. ***Echo*** përbën një konstelacion fragmentesh të vendosura përbri heshtjes së një Krishtlindjeje të ftohtë islandeze. Çdo fragment përfaqëson një zë që, në timbrin e tij, rreket të përqafojë shtrirjen e qytetërimit. Përveç tyre, programi përfshin edhe trilogjinë e sukseshme të filmave të shkurtër, filmin e fundit të shkurtër ***O*** (***Circle***) dhe filmin e fundit me metrazh të gjatë ***When the Light Breaks***, të cilët eksplorojnë humnerën e një njeriu vetëshkatërrues dhe pamundësinë e hidhërimit. Përzgjedhja e këtyre titujve u kurua nga Blerina Hankollari.

RetrospectTIFF

Për herë të parë, TIFF i kushton një hapësirë të veçantë kategorisë së Video Artit duke përfshirë dy programe, të cilat konsistojnë në: "***Obsession***", një shfaqje solo e videove të realizuara midis viteve 2006 dhe 2025 nga artisti ynë i mirënjohur Fani Zguro.

Citimi "*të paligjshmen e bëjmë menjëherë, jokushtetuesja zgjat pak më shumë*", është propozimi për programin tjetër retrospektiv "***Anarkistët***" nga artistët më të vlerësuar bashkëkohorë, si Miguel Calderon, Maria Thereza Alves & Jimmie Durham, Jakup Ferri, Dora Garcia, Manuela Garcia, Johan Grimonprez, Lia Perjovschi, Santiago Sierra, Bert Theis, Shingo Yoshida dhe Fani Zguro.

TIFF Classics

Premiera botërore e filmit të mirënjohur, dramës historike "***Liri a Vdekje***", 1979, i restauruar në 4K, do të shfaqet ekskluzivisht në TIFF në Kinemanë Millennium.
Restaurimi digjital i këtij filmi u mundësua nga projekti Sezoni i Filmave Klasikë - nismë e Shoqatës së Kinematekave Europiane (ACE), me mbështetjen e programit Europa Krijuese MEDIA të Komisionit Europian. Liri a vdekje u restaurua nga elementet origjinalë negativë 35mm. Skanimi i negativit në 4K u krye në studion e AQSHF-së në Tiranë dhe restaurimi në laboratorin e Augustus Color në Romë, Itali.

INDUSTRY EVENTS

4th SCREENPLAY ContesTIFF 2025
Synon të vlerësojë nga prodhuesit dhe distributorët tanë partnerë skenarin më të mirë dhe të mundshëm për t'u prodhuar prej tyre me shanset më të mëdha për t'u shpërndarë me sukses në festivalet më të njohura ndërkombëtare të filmave të shkurtër.
Partnerët tanë kanë nominuar 10 skenarë për Pitching dhe në Ceremoninë e Ndarjes së Çmimeve, 27 shtator 2025 do t'i shpërblejnë skenarët fitues me ***Distribution Award*** dhe mundësinë e nënshkrimit të një kontrate prodhimi ose distribucioni me fituesit.

Talking Shorts - diskutim në panel
TIFF 2025 prezanton, për herë të parë, bashkëpunimin me Talking Shorts, një diskutim në panel me ekspertë dhe kineastë të njohur mbi temën: ***Krijimi i Filmave me Buxhet të ulët***.

MASTERCLASS *Realizmi poetik në kinematografinë e Rúnar Rúnarsson*

me Rúnar Rúnarsson dhe moderuar nga Blerina Hankollari.

SPECIAL SCREENINGS

Oscar® Shortlist 2025 & EFA Shorts Tour 2024
Prej disa edicionesh është bërë traditë tashmë të sjellim çdo vit për publikun 5 nominimet e Best Short Film për Academy® Award si dhe 5 filmat më të mirë europianë të nominuar për Best European Short Film.

TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL

TIRANA FILM INSTITUTE

PANORAMA

me seksionet tematike dhe alternative si GENERATIONs, NEW WORLD, DIVERGENT MINDs, PARADE dhe për herë të dytë do të sjellim një program me filma të krijuar me **AI**.

KIDs & **TEENs** Program

është program i përvitshëm i dedikuar për fëmijë nga 5-10 dhe 11+ vjeç me 24 filma të shkurtër. Kino PIRAMIDA do të jetë në dispozicion të këtij programi ku fituesit do të dalin nga votat e fëmijëve.

COMPETITION & JURY

Konkurimi zyrtar konsiston në filmat e metrazhit të gjatë: PerspecTIFF dhe Documentary. Short Films: Live Action, Animation, Documentary, Video Art & Experimental, Students, Balkan shorts si dhe In ALBANIAn.

Këto kategori do të vlerësohen nga tetë juri ndërkombëtare të formuara nga personalitete të industrisë kinematografike, si:
Yves Piat, regjisor (*Francë - AMPAS member*); **Konstantina Kotzamani**, regjisore (*Greqi*); **Gianfilippo Pedote**, producent, regjisor dhe skenarist (*Itali*); **Or Sinai**, regjisore (*Izrael*); **Menelaos Karamaghiolis**, artist, kineast (*Greqi*); **Vuk Perovic,** kritik, film programmer (*Mali i Zi*); **Samir Ljuma**, kineast (*Hollandë*, *Maqedonia e Veriut*); **Fabrizio Bellomo**, artist, kineast (*Itali*); **Ana Nedeljković**, visual artist, regjisore, animatore (*Serbi*); **Adele Budina**, producente (*Italy*); **Joni Shanaj**, kineast (*Shqipëri*); **Bruno Carnide**, kineast, festival director (*Portugali*); **Adam Selo**, distributor, (*Itali*); dhe nga Shqipëria **Dritan Huqi**, producent; **Efijeni Kokedhima**, producente, kuratore; **Elis Mataj**, regjisor, pedagog filmi; **Anxhela Çikopano**, studiuese, pedagoge filmi; **Arti Lushi**, shkrimtar, poet, PR.

Për herë të parë, TIFF krijon një juri speciale, **Capture Frame Jury**, cila do të vlerësojë kuadrin më të bukur fotografik nga filmat dokumentarë. Kjo juri përbëhet nga artistë vizualë dhe kuratorë si Elton Koritari, Ena Bulku dhe Rubin Kadiu.

Student Critics Jury e formuar nga **studentë** të Universitetit të Arteve, të cilët përveç vlerësimit të filmave të zgjedhur në kompeticionin zyrtar do të jenë aktivë pas çdo seance filmike në kinema me Q&A, duke nxitur kështu mendimin kritik tek kineastët e rinj dhe iu dhënë mundësinë për t'u njohur e bashkëpunuar me regjisorët dhe producentët e huaj pjesëmarrës në TIFF.

Ceremonia e ndarjes së Çmimeve do të mbahet në 27 shtator, ora 19:00 në kinema Millenium.

VENUES

TIRANA INTERNATIONAL FILM FESTIVAL

TIRANA FILM INSTITUTE

Filmat dhe eventet e këtij edicioni do të shfaqen në kinema Millenium, Qendra e Artit AGIMI, Kino Piramida, Vila 31, Librari Babel si dhe online për ndjekësit e shumtë në Shqipëri dhe në botë.

STATISTIKA APLIKIME & SELEKSIONET

Në platformat online regjistruam rreth **3245 filma** dhe **59 skenarë**, që aplikuan këtë vit nga **115 vende** të botës.
Pas një pune të gjatë disa mujore grupi i selektorëve ka sugjeruar për këtë edicion të 23-të të TIFF 2025 rreth **192 filma** në konkurrim, 12 filma të metrazhit të gjatë dhe 180 filma të shkurtër bashkë me **10 skenarët** e përzgjedhur për Screenplay ContesTIFF. Të gjitha ato do të jenë premiera botërore, ndërkombëtare, rajonale ose kombëtare.
The Non-Competitive program përfshin 53 filma.

Në total këtë vit do të shfaqen 245 filma, nga të cilët **19 filma të metrazhit të gjatë** dhe **226 filma të shkurtër** nga **70 vënde** të botës.

INFO

Të gjithë ju që dëshironi të ndiqni eventet dhe premierat kombëtare të edicionit të 23-të Tirana International Film Festival 2025 jeni të lutur të plotësoni formularin te **ACCREDITATION**: http://tiranafilmfest.org/accreditation

Për më shumë informacion rreth edicionit të 23-të të Tirana International Film Festival 2025 mund të na vizitoni në faqen tonë web: tiranafilmfest.org, me më shumë detaje rreth Programit, Jurive, Awards dhe Press Kit.

- **SOCIALS**
  - **facebook**.com/TiranaFilmFest
  - **instagram**.com/tiranafilmfest
  - **twitter**@TiranaFilmFest
  - **youtube**.com/user/TiranaFilmFestival1
  - **vimeo**.com/ tiranafilmfest
  - **linkedin**.com/ company/1796049/admin